



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 29 AKTI

NR. 31 VENDIMI

Tiranë, më 04.07.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)

Kryesuese

Suela Zhegu

Relatore

Pamela Qirko

Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në Tiranë, më datë 3 korrik 2018, ora 10:00, në Pallatin e Kongreseve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Arta Ndrec Marku, me funksion Prokurore e Përgjithshme e përkohshme, pranë Prokurorisë së Përgjithshme,** e përfaqësuar nga avokatja Lirime Çukaj, me nr. licence 3094, me prokurë të posaçme me nr. 2087 rep., nr. 427 kol., anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë të znj. Marku.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe nenet Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,** miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”:
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisioneren Suela Zhegu, dëgjoi përfaqësuesen e subjektit të rivlerësimit, avokaten Lirime Çukaj, vëzhguesin ndërkombëtar; pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Arta Ndrec Marku, e cila kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. Arta Marku, me funksion Prokurore e Përgjithshme e përkohshme, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Znj. Marku, në funksionin e saj të mëparshëm ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe, sipas nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka shprehur interesin për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Për këtë shkak, bazuar në pikën 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar më datë 30 nëntor 2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 14.12.2017, u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues znj. Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Theo Jacobs.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (DSIK) dhe 3) Prokuroria e Përgjithshme (PP).

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillimin e hetimit administrativ.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Arta Marku, me shkresën nr. ***, datë 09.01.2018, drejtuar Komisionit, ka depozituar dorëheqjen si kandidate për anëtare në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

¹ Raporti nga ILDKPKI-ja është dërguar me nr. *** prot., datë 09.11.2017, shoqëruar me dosjen përkatëse të përbërë nga 483 fletë, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

1. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
2. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
3. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
4. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Marku”.

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, i ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

“Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet duken të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Pasi u hetua raporti i Prokurorisë së Përgjithshme, nuk u gjet indice apo element që mund të ngrinte dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes më datë 19.06.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Arta Marku, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

²Me shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2017, dërgohet raporti i DSIK-së.

³Me shkresën nr. *** prot., datë 15.01.2018, dërgohet raporti i Prokurorisë së Përgjithshme.

Më datë 19.06.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe u lajmërua se ka të drejtë të paraqesë pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me hetimin e kryer nga Komisioni, duke çmuar të mos njihet me dosjen. Gjithashtu, znj. Marku deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Arta Marku ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit.

PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Subjekti i rivlerësimit, znj. Arta Marku, me funksion Prokurore e Përgjithshme e përkohshme, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt përfshiu: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Gjatë procedurës së rivlerësimit të subjektit janë administruar akte nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor.

I. VLERËSIMI I PASURISË

Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë

Në bazë të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, relatori i çështjes ka kryer hetimin dhe vlerësimin e pavarur të të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjektet e së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

- 1. Apartament**, me sipërfaqe 103 m², me vlerë 5.000.000 (pesë milionë) lekë, i ndodhur në Shkodër, Rr. “****”, me nr. pasurie ***, ZK ***. Subjekti zotëron ½-tën e apartamentit, në bashkëpronësi me bashkëshortin.

Burimet e krijimit të kësaj pasurie⁴, të deklaruara nga subjekti, janë:

- Kontrata e kredisë bankare afatgjatë për blerje shtëpie me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.07.2007, pranë “Tirana Bank”, në shumën 3.500.000 lekë (tre milionë e pesëqind mijë), me interes 9.75 %, me afat 15 vjet;
- Hua në shumën 1.200.000 lekë (një milion e dyqind mijë) të marra nga nëna e subjektit (*Për këtë hua nuk është nënshkruar ndonjë dokument*); dhe
- 300.000 lekë (treqind mijë) kursime familjare.

Subjekti ka deklaruar (në Deklaratën-Vetting, shtojca nr. 2,) se pas blerjes së shtëpisë është marrë kredi konsumatore, sipas kontratës së kredisë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.11.2007, në “Tirana Bank”, në shumën 700.000 lekë (shtatëqind mijë), me afat 5 vjet, me objekt: Për nevoja personale.

Hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit⁵

Trupi gjykues, mbështetur në analizën ekonomike të të ardhurave dhe shpenzimeve, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë këtë apartament.

- ✓ *Nga hetimi i kryer nga Komisioni, nuk ka dyshime mbi këtë pasuri. Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.*

- 2. Apartament**, me sipërfaqe 60 m², ku bashkëshorti i znj. Marku zotëron 25 %, në lagjen “****”, Shkodër, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***. Ky apartament, në bashkëpronësi me familjarë të bashkëshortit të znj. Marku, është përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore, i deklaruar në vitin 2015, pas regjistrimit në ZVRPP Shkodër. Subjekti ka paraqitur certifikatë për vërtetim pronësie me nr. ***, datë 27.10.2014, sipas së cilës personi i lidhur zotëron ¼-tën e pasurisë.

⁴ Për këtë pasuri, subjekti ka bashkëlidhur këto dokumente:

- Kontratë shitblerjeje pasurie me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.06.2007, me vlerë 5.000.000 lekë;
- Kontratë kredie konsumatore me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.11.2007, pranë “Tirana Bank”, në shumën 700.000 lekë (shtatëqind mijë) dhe me afat 5 vjet;
- Vërtetim hipotekor, lëshuar më datë 26.06.2007 dhe harta treguese e regjistrimit.
- Vërtetim hipotekor nr. ***, datë 31.03.2015, për pasurinë me nr. ***, e ndodhur në ZK ***, për apartamentin me sipërfaqe 103 m², në adresën ***, lëshuar nga ZVRPP Shkodër, si dhe harta treguese.
- Kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., 01.11.2007, te “Tirana Bank”, me anë të së cilës është rihipotekuar apartamenti me sipërfaqe 103 m², i ndodhur në adresën ***, adresa sipas sistemit të ri të adresave: ***, Rr. ***, pallati nr. ***, Shkodër, me nr. pasurie ***, e ndodhur në ZK ***.
- Certifikatë familjare.
- Fotokopje pasaporte të subjektit të vlerësimit dhe bashkëshortit.

Nga informacioni i marrë nga “Tirana Bank”, me kërkesën e Komisionit, me nr. *** prot., datë 17.01.2018, konfirmohet marrja e kësaj kredie, si dhe kontrata e hipotekimit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.07.2007.

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 05.01.2018, drejtuar ZQRPP-së.

Me shkresën nr. *** prot., datë 26.01.2018, ZVRPP-ja ka konfirmuar regjistrimin e kësaj pasurie.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

ZVRPP Shkodër⁶ ka konfirmuar pasurinë e cituar më sipër.

Komisioni, nga analiza e fakteve, ka konstatuar se:

✓ *Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar dhe përgjigjet e ardhura nga institucionet.*

- 3. Shtesë në apartamentin** e sipërcituar, me sipërfaqe 3 x 3 metra (9 m²), aktualisht në proces legalizimi. Shtesa është në bashkëpronësi të S, F, E dhe O.Ç. Legalizimi i kësaj shtese është kërkuar nga E.Ç. Ndërtimi është bërë për një periudhë kohe prej 2 vjetësh, me shpenzime të ndara dhe jo njëkohësisht (personi i lidhur zotëron 25 % të shtesës⁷).

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

ALUIZNI,⁸ me shkresën ***, datë 28.12.2017, ka konfirmuar praktikën e deklaruar nga subjekti për legalizimin e shtesës me sip. 9.6 m², shtesë e kryer tek apartamenti 60 m², i përfituar nga privatizimi me praktikën bashkëlidhur. Në përgjigje, rezulton vendimi nr. ***, datë 26.12.2014, “Për kualifikim për legalizim të objektit informal në posedim të z. E.Ç”, i datës 26.12.2014.

Komisioni, nga analiza e fakteve ka konstatuar se:

✓ *Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar dhe përgjigjet e ardhura nga institucionet.*

- 4. Autoveturë**⁹ (në përdorim), tip “Volkswagen”, viti i prodhimit 2003, me vlerë 5.600 euro, me datë leje qarkullimi 03.08.2009, në emër dhe pronësi të shtetasit O.Ç., emigrant në Gjermani prej 20 vjetësh, i cili është vëllai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Kjo autoveturë i është lënë në përdorim bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, sipas prokurës së posaçme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.08.2009.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

⁶ Komisioni, me shkresat nr. *** prot., datë 21.12.2017, drejtuar ZQRPP-së, si dhe shkresat nr. *** prot., datë 15.01.2018, nr. *** prot., datë 26.03.2018, drejtuar ZVRPP-së Shkodër, ka kërkuar informacion mbi pasuritë e regjistruara në Shkodër, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

⁷ Për këtë, subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues: Vërtetim me nr. *** prot., datë 16.01.2017, lëshuar nga ALUIZNI Shkodër dhe bashkëlidhur praktika e aplikimit për legalizim.

⁸ Në dosjen e subjektit ndodhet shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 21.12.2017, drejtuar Drejtorisë së ALUIZNI-t “Zonat Turistike” Tiranë dhe ALUIZNI-t Shkodër, ku është kërkuar dosja e plotë mbi aplikimin për vetëdeklarim të pasurive të paluajtshme në proces legalizimi, për subjektin e rivlerësimit dhe për personin e lidhur.

⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur praktikës dokumentet:

- Faturë shitjeje në shumën 5.600 euro, leje qarkullimi e përkthyer për transport të automjetit, dokumente në gjuhën gjermane, si dhe pasaporta të pronarit të automjetit, z. O.Ç.;
- Vërtetim hyrjeje me nr. *** prot., datë 01.09.2009, në Han të Hotit të personit dhe automjetit, deklaratë doganore, dokument lëshuar nga Dogana Shkodër “Urdhër çlirim”, datë 31.07.2009, ora 12:00.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor¹⁰ (referuar si “DPSHTRR”) me shkresën me nr. ***, datë 27.12.2017, informon se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë automjet në pronësi të tyre.

DPSHTRR-ja, me shkresën nr. ***, datë 27.12.2017, informon gjithashtu se automjeti me targë ***, me leje qarkullimi *** është regjistruar për herë të parë në Drejtorinë Rajonale Shkodër, më datë 03.08.2009, në pronësi të shtetasit O.S.Ç.

DPSHTRR Shkodër, me shkresën nr. *** prot., datë 05.01.2018, konfirmon të dhënat e deklaruara nga subjekti, si dhe ka bashkëlidhur dosjen e plotë të automjetit me targën ***, e cila i korrespondon makinës që kanë në përdorim bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit.

Komisioni ka kërkuar informacion dhe dokumentacion lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e makinës nga shtetasi O.Ç. (pronari i makinës) në cilësinë e personit tjetër të lidhur. Subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e pyetësorit të datës 06.04.2018, ka shpjeguar se: “Kunati i saj, z. O.Ç., është emigrant i ligjshëm në Gjermani prej shumë vitesh dhe të ardhurat e automjetit burojnë nga puna e tij, i cili ka pasur një ndërmarrje të tijën për disa vite, përfshirë vitin 2008, 2009 dhe 2010. Ndërmarrja ka qenë në emër të O.Ç., ***”. Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur dokumente të z. O.Ç., për të provuar të ardhurat e tij për vitet 2008, 2009, të nxjerra nga kontabiliteti. Nga analiza financiare ka rezultuar se personi tjetër i lidhur ka pasur të ardhura të mjaftueshme në momentin e fitimit të kësaj pasurie.

Komisioni, nga analiza e fakteve ka konstatuar se:

- ✓ *Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar dhe përgjigjet e ardhura nga institucionet. Dokumentacioni ligjor i paraqitur nga “personi tjetër i lidhur” justifikon burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie në momentin e fitimit.*

5. Kredi në bankën “Societe Generale Albania”¹¹, e cila është marrë me qëllim mbylljen e kredisë të “Tirana Bank” dhe kalimin e detyrimeve të kredisë¹² “për shtëpi” pranë bankës “Societe Generale Albania” sh.a. Gjendja e detyrimit të mbetur është 2.134.386 lekë, pranë bankës “Societe General Albania”.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

¹⁰ Shkresë e Komisionit me nr. *** prot., datë 21.12.2017, drejtuar DPSHTRR-së, ku kërkohet informacion mbi çdo automjet të regjistruar në emër të subjektit apo personit të lidhur me të.

¹¹ Shih në dosje kontratë kredie bankare afatgjatë për shtëpi, nr. *** rep., nr. *** kol., “Societe Generale Albania”, datë 03.04.2015, me afat 7 vjet deri në datën 17.08.2022, në shumën 2.700.000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë. Interesi bankar është 5.7 % dhe kësti mujor është 37.000 lekë. Shuma e mbetur e detyrimit është 2.134.386,65 lekë.

¹² Për këtë kredi, subjekti ka depozituar dokumentet shkresore:

- Kontratë kredie bankare afatgjatë për shtëpi, nr. *** rep., nr. *** kol., “Societe Generale Albania”, datë 03.04.2015, me afat 7 vjet deri në datën 17.08.2022.
- Kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., për pasurinë në pronësi të subjektit të rivlerësimit;
- Kërkesë për pajisje me vërtetim për mbyllje detyrimi, i datës 09.04.2015;
- Vërtetim i gjendjes së detyrimeve e “Tirana Bank” me nr. ***, datë 10.04.2015;
- Plan i amortizimit të kredisë, nr. ***, datë 17.04.2015, i bankës “Societe Generale Albania”;
- Plani i amortizimit të kredisë, nr. ***, datë 12.01.2017, i bankës “Societe Generale Albania”.

Të ardhurat që subjekti dhe personi i lidhur kanë gjeneruar këto dy vite u mundësojnë atyre që të shlyejnë lehtësisht kredinë, si dhe të kenë mundësi të kryejnë shpenzime të tjera apo dhe të kenë mundësi të kursejnë.

Komisioni, nga analiza e fakteve ka konstatuar se:

- ✓ *Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar dhe me përgjigjet e ardhura nga institucionet.*

6. Hua e deklaruar nga subjekti.

Subjekti ka deklaruar se në vitin 2007 ka marrë hua nga nëna e saj, në shumën prej 1.200.000 lekësh, pa kontratë. Komisioni ka bërë hetim mbi të ardhurat e nënës së subjektit, znj. L.M. Nga informacioni i ardhur nga banka, verifikohet pakësimi i depozitës së nënës së subjektit, në shumën 1.500.000 lekë.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

Nga të dhënat e ardhura nga "Raiffeisen Bank", për periudhën në të cilën ka dhënë hua, verifikohet që nëna e subjektit ka pasur burime të mjaftueshme financiare për të dhënë hua në shumën 1.200.000 lekë, në vitin 2007.

Komisioni i ka kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimet e ligjshme të krijimit të shumave të mësipërme, për personat e tjerë të lidhur.

Referuar deklaratës së dorëzuar më 24.03.2005, znj. Arta Marku ka deklaruar aktivitetin privat (tregti ambulator) që prej vitit 1993, në Fushë-Arrëz, për nënën e saj, znj. L.M., e cila disponon depozitë bankare pranë "Raiffeisen Bank", në vlerën 2.000.000 lekë, si të ardhura nga puna në një dyqan provizor (kioskë) të marrë me qira.

Qendra Kombëtare e Biznesit¹³, me shkresën me nr. *** prot., datë 15.01.2018, konfirmon se shtetasja L.M figuron e regjistruar si person fizik me NUIS ***.

Komisioni i ka kërkuar subjektit informacion dhe dokumentacion në lidhje me burimet e ligjshme të krijimit të shumave të mësipërme. Subjekti ka shpjeguar, duke e provuar, se: *Nëna e saj nga aktiviteti privat ka depozituar kursime në vite, pranë 'bankës së kursimeve' që nga viti 2000 e në vazhdim, përpara se subjekti të emërohej në detyrën e prokurores, si dhe shuma që rezulton në "Raiffesisen Bank" ka rezultuar si kursime të vëna në vite, të kaluara më pas në "Raiffeisen Bank."*

Përfundimisht, u konstatua se përputhen shpjegimet e subjektit me deklaratimet e saj periodike, si dhe me dokumentacionin provues të paraqitur.

Nga analiza financiare e Komisionit ka rezultuar se:

- ✓ *Subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të shlyer huan e marrë.*

¹³Shih në dosje shkresën e Komisionit nr. *** prot., datë 21.12.2017, drejtuar QKB-së, ku i kërkohet informacion dhe dokumentacion mbi marrëdhënie të mundshme biznesi, veprimtarie tregare apo veprimtari profesionale, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

Komisioni, nga vlerësimi në tërësi i pasurisë, nuk ka konstatuar elemente të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Marku. Deklarimet e saj janë të mjaftueshme, pas verifikimit ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e likuiditeteve të deklaruara në Deklaratën-Vetting dhe ato ndër vite.

Rekomandimi i relatorit për vlerësimin e pasurisë

Sa më sipër, pavarësisht nga raporti i hollësishëm i dërguar nga ILDKPKI -ja për të bërë një vlerësim të pasurisë së subjektit të rivlerësimit sa më objektiv dhe të paanshëm, është kryer hetim administrativ nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ, ka rezultuar se nuk ka dyshime mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe llogaritë e subjektit të rivlerësimit, përfshi dhe llogaritë e personave të lidhur me të. Po kështu, në të gjitha rastet e hetuara përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga institucionet shtetërore.

Nga analiza financiare për periudhën 2002 - 2016, nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Marku¹⁴ dhe të ardhurat e personit të lidhur, bashkëshortit¹⁵, ka rezultuar se kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për blerjen e pasurive të deklaruara, si dhe për shpenzimet e kryera.

Sa më sipër, nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se nuk janë konstatuar elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

II. KONTROLLI I FIGURËS

¹⁴ Të ardhura nga paga si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier dhe Shkodër në shumën 16.313.660 lekë (duhet të jetë për të gjithë periudhën e punësimit, por nga dokumentacioni nuk del e qartë).

- Të ardhura nga leja e barrëindjes, datë 04.04.2010 - 15.07.2010, në shumën 215.820 lekë;
- Të ardhura nga paga si pedagoge e jashtme në Universitetin privat “***” Shkodër për periudhën 2010 - 2014 në shumën 342.429 lekë. Subjekti i ka bashkëngjitur këtë dokumentacion justifikues:

- Vërtetim me nr. ***, datë 18.10.2016, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier;
- Vërtetim me nr. ***, datë 18.10.2016, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- Vërtetim me nr. ***, datë 09.01.2017, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- Vërtetim datë 24.10.2016, nga shkolla “***” Shkodër;
- Vërtetim nga ISSH Shkodër, me nr. ***, datë 06.01.2017;

¹⁵ Të ardhura nga paga si oficer i Policisë Gjyqësore, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në shumën 12.380.964 lekë; Subjekti, për personin e lidhur ka paraqitur dokumentacionin justifikues si vijon:

- Vërtetim page, nr. ***, datë 21.10.2016, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- Vërtetim page, nr. ***, datë 09.01.2017, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar *mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Marku.*

Për vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Marku, është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke bërë disa verifikime mbi pastërtinë e figurës, duke hetuar mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Rekomandimi për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për sa i përket elementit të pastërtisë së figurës, për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës si prokurore.

III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi vlerësimin e aftësive profesionale

Raporti për analizën e aftësive profesionale, i kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, është bazuar në:

- Formularin e vetëdeklarimit, 3 (tre) dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe te të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 (pesë) dosjet penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- Të dhënat nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjithashtu, raporti i hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme është bazuar duke iu referuar kritereve të vlerësimit, si:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- d) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Në 10 vjetët e fundit, znj. Marku ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Shkodër dhe, njëkohësisht, nga viti 2010 si pedagoge e jashtme në Universitetin Privat “Gjon Buzuku” Shkodër.

a) Lidhur me aftësitë profesionale

Znj. Marku për vitet 2014, 2015 dhe 2016 është vlerësuar në kategorinë “Shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej saj, gjatë kryerjes së detyrës si prokurore dhe zv.drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

Subjekti Arta Marku shfaq aftësi në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Në vendimmarrjet e saj përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret. Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale dhe veprave penale të parashikuara në Kodin Penal. Po kështu, shfaq njohuri të plota dhe të admirueshme në drejtim të normave të Kodit të Procedurës Penale dhe metodikës së hetimit.

b) Lidhur me aftësitë organizative

Në dokumentet ligjore të përzgjedhura, rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

Kur subjekti ka pasur rolin e kontrollit të hetimeve, ka evidentuar me hollësi mangësitë e konstatuara në hetimet e kryera. Po kështu, ka lënë detyra të hollësishme në formë orientimesh për hetimet e mëtejshme, fakt që flet për një studim paraprak të thelluar dhe administrimin e çdo të dhëne të rëndësishme në aktet e procedimeve penale përkatëse.

c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Në lidhje me vlerësimin e etikës në punë, subjekti Arta Marku për vitet 2014, 2015 dhe 2016 është vlerësuar “Shumë mirë” për etikën profesionale. Për subjektin Arta Marku nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth cenimit të integritetit të saj, si dhe nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar.

d) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional, për subjektin e rivlerësimit nuk rezultojnë të dhëna konkrete mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë. Subjekti Arta Marku, sipas formularit të vetëdeklarimit, rezulton se për periudhën vlerësimit është angazhuar në shumë aktivitete profesionale.

Nga ana e Komisionit, vlerësimi i aftësive profesionale u bazua në gjetjet e raportit të PP-së, në shpjegimet e dhëna nga subjekti, denoncimet e ardhura, si dhe në analizën e bërë, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku u konstatuan problematikat si më poshtë:

- Në një prej çështjeve të përzgjedhura me short, që i përket procedimit penal nr. 498, regjistruar në datën 20.03.2016, i pandehur A.B., akuzuar për veprën penale “*Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt*”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, dërguar për gjykim të drejtpërdrejtë nga subjekti i rivlerësimit në datën 21.03.2016, u vërejt se masa e sigurisë “arrest me burg” është një masë kufizuese që mund të konsiderohet si “*extrema*

ratio”, siç është treguar qartë në kreun I të Kodit të Procedurës Penale në Republikën e Shqipërisë (nenet 228, 229 dhe 230) dhe në përputhje me nenin 5) të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Subjekti i rivlerësimit duhet të kishte arsyetuar qartë, me detaje, shkaqet që justifikonin nevojën absolute për kufizimin e lirisë së të pandehurit dhe se, kërkesa për “arrest me burg” ishte tërësisht e nevojshme dhe e mbështetur në ligj.

Lidhur me këtë çështje, në seancën dëgjimore të datës 03.07.2018 vëzhguesi ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, u ndal gjatë, duke iu drejtuar avokates Çukaj, me cilësinë e përfaqësueses ligjore të znj. Marku. Z. Jacobs, ndër të tjera, theksoi faktin se: *“Në vitin 2011, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë thënë se kërkesat e parashtruara nga ana e prokurorit dhe vendimet e gjykatës, për sa i përket caktimit të masave të sigurisë, duhet të jenë të motivuara dhe duhet të argumentohet nevoja për këto masa, ekzistencën e faktorëve të rëndësishëm të rrezikut, që do të thotë probabilitetin dhe mundshmërinë reale që do të mundte të ndodhte, si dhe vënien në rrezik të provave nga ana e të pandehurit. Rreziku i shmangies nga drejtësia duhet të motivohet, të mbështetet me elemente konkrete faktesh dhe rrethanash objektive... Këto janë fjalë shumë të mençura të Gjykatës së Lartë dhe vijnë në përputhje të plotë me jurisprudencën europiane”.* (Fjala e vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, u përkthye e plotë nga përkthyesja A.I dhe është pjesë e dosjes.)

Avokatja Çukaj shprehu dakordësinë mbi komentet e vëzhguesit ndërkombëtar, duke shtuar, ndër të tjera, se:

“Kur kryhet arresti në flagrancë, si veprime procedurale që kufizojnë lirinë e lëvizjes së individit si liri themelore. Një nga qëllimet për të cilat vendoset masa e sigurimit është parandalimi i përgjithshëm i kryerjes së mëtejshme të veprave penale. Nga Prokuroria, si subjekt kërkues për caktimin e masave të sigurimit apo vleftësimit të ligjshëm të arrestit, konsiderohet e përshtatshme caktimi i një mase sigurimi të tillë, me efekt parandalimin e kryerjes së ndonjë vepre tjetër penale... Prokuroria është subjekti që kërkon caktimin e masave të sigurimit, ndërkohë që vendimin e merr gjykata.”

Mungesa në seancë e znj. Marku nuk krijoi mundësinë për të debatuar.

- Subjekti i rivlerësimit, duke pasur përkohësisht pozicionin e Prokurores së Përgjithshme - të mandatuar nga Parlamenti i Shqipërisë më 18.12.2017, ka ndërmarrë disa hapa për ristrukturimin dhe riorganizimin e Prokurorisë së Përgjithshme, duke urdhëruar ndërprerjen e komandimit të disa prokurorëve dhe duke komanduar disa prokurorë të tjerë në mbështetje të grupit të punës, si dhe ka ricaktuar disa pozicione udhëheqëse.

Komisioni ka evidentuar faktin se, ndërsa autoriteti i subjektit të rivlerësimit për të ndërmarrë këto aktivitete është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, vërehet se subjekti i rivlerësimit paraqet “ushtrimin e funksioneve kushtetuese në mënyrë objektive dhe efikase, si dhe rritjen e besueshmërisë në sytë e qytetarëve”, si një nga qëllimet e ristrukturimit.

Subjekti i rivlerësimit u pyet specifikisht, për të sqaruar “metodologjinë” e ndjekur në këtë riorganizim. Në përgjigje, znj. Marku ka sqaruar se: *“Nuk ka procedurë për përzgjedhjen e personave që do të caktohen përkohësisht, por pavarësisht mungesës së një procedure të*

paracaktuar, vendimet janë të bazuara në disa kritere, duke përfshirë: përvojën e punës, natyrën e çështjeve të hetuara, arsimin dhe opinionet e përgjithshme të mbledhura nga kolegët e tyre”.

Komisioni, në lidhje me ‘metodologjinë’ e përdorur në riorganizimin e janarit të vitit 2018, të kryer në institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme vëren se, që nga janari, subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë asnjë hap për të përmirësuar ‘procedurën e emërimit’ për ta bërë atë më transparente.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua dhe në dy denoncime, të paraqitura pranë Komisionit. Pas verifikimit të këtyre denoncimeve, konstatohet se çështjet janë gjykuar dhe vlerësimi i çështjeve nga prokurori është gjetur i drejtë nga shkallët e gjyqësorit.

Komisioni vlerëson se mangësitë e konstatuara në vlerësimin profesional janë formale dhe nuk janë në atë nivel, sa të cenojnë aftësitë profesionale të prokurores.

Rekomandimi i relatorit për vlerësimin e aftësive profesionale

Për sa më sipër, me cilësinë e relatores së çështjes, mbështetur në raportin e Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme. Nuk gjeta asnjë indice apo element që cenon figurën e prokurores, znj. Arta Marku, sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, kështu që për subjektin e rivlerësimit propozoj: “E aftë”.

SEANCA DËGJIMORE

Duke qenë se subjekti i rivlerësimit u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më datë 19.06.2018, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Arta Marku, në seancë dëgjimore në datën 03.07.2018, ora 10:00, në Pallatin e Kongreseve, në Tiranë, si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit.

Znj. Arta Marku është njoftuar nëpërmjet komunikimit elektronik, me *e-mail*, në datën 26.06.2018, për të cilin edhe ka komunikuar marrjen dijeni dhe nuk ka pasur pretendime apo kërkesa të tjera shtesë.

Në seancën dëgjimore të datës 03.07.2018, subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit personalisht, por u përfaqësua nga avokatja Lirime Çukaj, e cila deklaroi se ishte dakord me rezultatet e hetimit dhe kërkoi për subjektin e rivlerësimit rikonfirmimin në detyrë.

IV. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoji përfaqësuesen ligjore të subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore publike,

konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të pranueshëm të vlerësimit të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Znj. Arta Marku, me funksion Prokurore e Përgjithshme e përkohshme.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 04.07.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)
Kryesues

Suela ZHEGU
Relator

Pamela QIRKO
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj